

# Garë ndërkombëtare KENGUR 17.03.2016


## Klasa e 6 dhe 7 -Kategorija Benjamin

Koha në disponim është 1h e 15 min.

Për përgjigje jo të saktë të pyetjes minusohet një e katërta e numrit të pikëve me të cilat vlerësohet kjo pyetje. Për të shmangur rezultat të përgjithshëm negativ në fund shtohen 30 pikë, kështu që sasia maksimale e pikëve të fituara është 150. Gjatë punës nuk lejohen kalkulatorët.

### Cdo detyrë me numër rendor nga 1 deri 10 vlerësohet me 3 pikë

1. Cila prej tabelave të mëposhtme të qarkullimit rrugor ka më shumë boshte simetrie?




2. Miri pret një picë në katër pjesë të barabarta. Më pas, secilën prej pjesëve të fituara e pret në tre pjesë të barabarta. Ç'pjesë nga e gjithë pica përfaqëson një prej pjesëve të përfutuara të picës?

(A) një e treta (B) një e katërta (C) një e shtata (D) një e teta (E) një e dymbëdhjeta


3. Një litar me gjatësi 10 cm është lakuar si në vizatimin djathtas. Më pas, litari është prerë në dy vendet e shënuara, dhe janë përfutur tre litarë më të shkurtër. Sa janë gjatësitë e litarëve më të shkurtër?

(A) 3 cm, 5 cm, 2 cm (B) 2 cm, 2 cm, 6 cm (C) 1 cm, 4 cm, 5 cm  
(D) 1 cm, 3 cm, 6 cm (E) 3 cm, 3 cm, 4 cm




4. Në frigoriferin e Norës, 8 magnetë mbajnë disa kartolina (vizatimi djathtas). Sa magnetë më së shumti mund të heq Nora, por në mënyrë të tillë që asnjë kartolinë të mos bjerë përtokë?

(A) 2 (B) 3 (C) 4 (D) 5 (E) 6



5. Nora vizatoi një katror me brinjë 10 cm. Pastaj, ajo i bashkoi meset e brinjëve të katrorit, dhe fitoi katror më të vogël (vizatimi djathtas). Sa është suprina e katrorit më të vogël?

(A)  $10\text{cm}^2$  (B)  $20\text{cm}^2$  (C)  $25\text{cm}^2$  (D)  $40\text{cm}^2$  (E)  $50\text{cm}^2$



6. Mira në tavolinë vendosi tre pjata me pirunë dhe thika si në vizatimin djathtas. Nëna e saj i kërkoi pranë çdo pjate të ketë thikë në anën e djathtë dhe pirun në anën e majtë të pjatës. Sa ndryshime të vendeve të thikave dhe pirunjve më së pakti duhet të bëjë Mira, në mënyrë që t'i vendosë sipas kërkesës së nënës?


(A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 5 (E) 6




7. Një shumëkëmbëshe ka 25 palë këpucë. Shumëkëmbëshes i duhet nga një këpucë për secilën këmbë, ajo ka 100 këmbë. Edhe sa këpucë duhet të blejë me qëllim që të mbathet?

(A) 15 (B) 20 (C) 35 (D) 50 (E) 75

8. Miri dhe Tani kanë numër të njëjtë kubesh identike. Nga kubet e tij Miri formoi paraleloiped si në figurën djathtas.






Tani kubet e tij i radhit në mënyrë të tillë që radha e parë duket si në figurën majtas. Sa radhë ka trupi që formoi Tani ?


- (A) 2 (B) 3 (C) 4 (D) 5 (E) 6

9. Në anën e majtë të dhomës, Marija dhe Meri flenë me fytyra të kthyer nga njëra-tjetra. Në anën e djathtë të dhomës, Katja dhe Kristina flenë me kurriz të kthyer njëra me tjetrën. Sa vajza gjithsej flenë në mënyrë që veshi i tyre i djathtë e prek jastëkun ?



- (A) 0 (B) 1 (C) 2 (D) 3 (E) 4


10. Një letër është prerë si në figurën djathtas dhe nga kjo letër është formuar një kuti e hapur. Kutia është e vendosur mbi tavolinë në mënyrë që pjesa e saj e hapur qëndron sipër. Cila anë e kutisë shtrihet mbi tavolinë?



- (A) A (B) B (C) C (D) D (E) E

**Cdo detyrë me numër rendor nga 11 deri 20 vlerësohet me 4 pikë**

11. Jepen dy katrorë të njëjtë (vizatimi djathtas). Cila nga figurat e mëposhtme nuk mund të fitohet duke ngjitur këto katrorë?




- (A) (B) (C) (D) (E)

12. Meri, Teuta dhe Blerina punojnë në kopësht. Çdo ditë, nga e hëna deri të premte, në punë vijnë dy prej tyre. Meri punon 3 ditë në javë, ndërsa Teuta punon 4 ditë në javë. Sa ditë në javë punon Blerina?

- (A) 1 (B) 2 (C) 3 (D) 4 (E) 5

13. Pesë nuselale A, B, C, D dhe E janë rrjeshtuar në vijë të drejtë si në vizatimin më poshtë. Në vijë ka 6 lajthi të shënuara me yll. Në një moment secila nuselale filloi të vrapojë me shpejtësi të njëjtë tek lajthija më e afërt. Pasi nuselalja do të marrë lajthi ajo vazhdon të vrapojë tek lajthija tjetër më e afërt. Cila nuselale do të marrë dy lajthi?



- (A) A (B) B (C) C (D) D (E) E


14. Në një klasë ka 30 nxënës. Ata janë ulur në çifte në mënyrë të tillë që çdo djalë rri me një vajzë dhe saktësisht gjysma e vajzave rrinë me djem. Sa djem ka në klasë?


- (A) 25 (B) 20 (C) 15 (D) 10 (E) 5

15. Numri 2581953764 është shkruar në një fletë letre në formë shiriti. Miri e preu shiritin dy herë kështu që numrin 2581953764 e ndau në tre numra. Më pas, Miri i mblodhi numrat e fituar. Cila është shuma më e vogël që mund të fitojë Miri ?

- (A) 2675 (B) 2975 (C) 2978 (D) 4217 (E) 4298

16. Miri duhet të shkonte në barber. Kur pa në pasqyrë, akrepat e orës ndodheshin në pozicionin si në vizatimin djathtas. Çfarë do të shikonte Miri, nëse do të shihte në pasqyrë dhjetë minuta më herët ?





17. Teuta bleu nga dyqani ushqim për katër macet e saj, me të cilin mund t'i ushqejë macet për 12 ditë. Në të kthyer, ajo gjeti dy mace të rrugës dhe i çoi ato në shtëpi. Nëse Teuta çdo mace e ushqen njëditë, për sa ditë do të harxhohet ushqimi i blerë ?

- (A) 8                      (B) 7                      (C) 6                      (D) 5                      (E) 4


18. Në fjalën BENJAMIN çdo shkronje i përgjigjet njëra nga shifrat 1, 2, 3, 4, 5, 6 ose 7, kështu që shkronjave të ndryshme i përgjigjet shifër e ndryshme. Fjala BENJAMIN është tek dhe plotpjestohet me 3. Cila shifër i përgjigjet shkronjës N?

- (A) 1                      (B) 2                      (C) 3                      (D) 5                      (E) 7

19. Miri, Tani dhe Luli janë trinjakë (vëllezër të lindur në një ditë), ndërsa vëllai i tyre Shpendi është 3 vjet më i vogël. Cili nga numrat e mëposhtëm mund të jetë shuma e viteve të katër vëllezërve?

- (A) 53                      (B) 54                      (C) 56                      (D) 59                      (E) 60



20. Perimetri i drejtkëndëshit  $ABCD$  është  $30\text{ cm}$ . Tre drejtkëndësha të tjerë janë vendosur në mënyrë të tillë që qendrat e tyre gjenden në pikat  $A, B$  dhe  $D$  (figura djathtas). Shuma e perimetrave të tyre është  $20\text{ cm}$ . Sa është shuma e gjatësive të brinjëve të vijave më të errëta?



- (A)  $50\text{ cm}$                       (B)  $45\text{ cm}$                       (C)  $40\text{ cm}$   
 (D)  $35\text{ cm}$                       (E) nuk mund të përcaktohet

**Cdo detyrë me numër rendor nga 21 deri 30 vlerësohet me 5 pikë**

21. Ana paloste letër në formë rrethi përgjysmë. Figurën e fituar e përtheu përgjysëm, këtë veprim e përsëriti edhe njëherë (shikoje figurën).












Më pas Ana, e preu fletën e palosur siç është treguar në vizatimin djathtas. Cilën figurë e fitoi Ana pasi e shpalosi fletën?

- (A)                      (B)                      (C)                      (D)                      (E)

22. Miri i shkroi të gjithë numrat me këto cilësi : shifra e parë është 1, çdo shifër pasardhëse është më e madhe ose e njëjtë me shifrën paraardhëse, shuma e shifrave është e barabartë me 5.

- Sa numra shënoi Miri ?  
 (A) 4                      (B) 5                      (C) 6                      (D) 7                      (E) 8

23. Sa është numri më i madh i figurave me këtë pamje  të cilat mund të priten nga një katror me përmasa  $5 \times 5$  ?  
 (A) 2 (B) 4 (C) 5 (D) 6 (E) 7 
24. Luli filloi me punë në një restorant të vogël të vetin. Miku i tij Artani i dha disa tavolina katrore dhe disa karrige. Në qoftë se Luli i përdor të gjitha tavolinat më vete kështu që përreth secilës tavolinë do të vendosë nga 4 karrige, do t'i duhen akoma edhe 6 karrige. Nëse ai do t'i përdorë të gjitha tavolinat në mënyrë të tillë që t'i bashkojë nga dy dhe përreth çdo dy tavolinave do të vendosë nga 6 karrige, do t'i ngelen 4 karrige. Sa tavolina mori Luli nga Artani ?  
 (A) 8 (B) 10 (C) 12 (D) 14 (E) 16
25. Meri do të formojë një trekëndësh të madh duke shfrytëzuar trekëndësha të vegjël të ngjashëm. Ajo i vendosi tashmë disa trekëndësha të vegjël si në vizatimin djathtas. Cili është numri më i vogël i trekëndësheve të vegjël me të cilët Meri mund t'a mbarojë trekëndëshin e madh?   
 (A) 5 (B) 9 (C) 12 (D) 15 (E) 18
26. Kubi i madh është formuar nga 8 kube të vogla identike të bardhë dhe të zinj. Pesë faqet e kubit të madh janë paraqitur në figurën djathtas. Si e ka pamjen ana e gjashtë e kubit të madh ?  
 (A)  (B)  (C)  (D)  (E) 
27. Në figurën e vizatimit djathtas Nora shkroi numra në pesë prej dhjetë rrrathëve. Ajo do që të shkruajë numra edhe në pesë rrrathët e mbetur kështu që shuma e tre numrave në secilën prej brinjëve të pesëkëndëshit të jetë e njëjtë. Cilin numër duhet t'a shkruajë në rrethin e shënuar me  $X$ ?   
 (A) 7 (B) 8 (C) 11 (D) 13 (E) 15
28. Simbolet  $\bigcirc$ ,  $\square$  dhe  $\triangle$  përfaqësojnë tre shifra të ndryshme. Po të mblidhen shifrat e numrit treshifror  $\bigcirc\square\bigcirc$  fitohet numri dyshifror  $\square\triangle$ . Po të mblidhen shifrat e numrit dyshifror  $\square\triangle$ , fitohet numri njëshifror  $\square$ . Cila shifër është përfaqësuar me  $\bigcirc$ ?  
 (A) 4 (B) 5 (C) 6 (D) 8 (E) 9
29. Kenguri Kërcimtar luante me kalkulatorin e tij. Kërcimtari filloi me numrin 12 dhe 60 herë me radhë shumëzonte ose pjesëntonte me 2 ose me 3 dhe gjithnjë rezultati ishte numër pozitiv. Cili nga rezultatet e mëposhtme nuk mund të fitohet me mënyrën e përshkruar më sipër ?  
 (A) 12 (B) 18 (C) 36 (D) 72 (E) 108
30. Tek dy numra treshifrorë të gjitha 6 shifrat janë të ndryshme. Shifra e parë e numrit të dytë është dy herë më e madhe sesa shifra e fundit e numrit të parë. Cila është shuma më e vogël e mundshme e dy numrave të tillë ?  
 (A) 552 (B) 546 (C) 301 (D) 535 (E) 537